



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 76, datë 28.08.2009

MBI

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN “PËR MBAJTJEN DHE
RUAJTJEN E REGJISTRAVE TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA,
AUTORIZUARA DHE MIRATUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Në Rregulloren “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” miratuar me vendimin e Bordit nr. 17, datë 21.03.2007, të ndryshuar, të bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:**

Neni 1

Në fund të nenit 4 , shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Regjistër për subjektet që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë.”.

Neni 2

Në nenin 16 pika 3, fjalët “vendimi i regjistrimit në Gjykatë” zëvendësohen me fjalët “ekstrakti i regjistrimit në QKR”- “data e regjistrimit të subjektit” .

Pas pikës 3 shtohen fjalët : “ numri i NIPT-it”.

Neni 3

Shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

Neni 21/1

Të dhëna për subjektet që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë

1. Për subjektet, shoqëri tregtare, që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë, regjistri përmban këto të dhëna:

- a. Emri i shoqërisë.*
- b. Kodi i vendosur, sipas aneksit 1.*
- c. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë/ data e regjistrimit*
- d. Numri i NIPT-it.*
- e. Selia.*
- f. Adresa, nr. i tel, fax, website dhe adresa e e-mail.*
- g. Selia dhe adresa e degëve (nëse ka).*
- i. Afati i aktivitetit (jetës) të shoqërisë.*
- j. Drejtuesi i shoqërisë.*
- k. Personi përgjegjës për komunikimin dhe shpërndarjen e analizave financiare.*
- l. Shënime të tjera.*

2. Për subjektet, tregtarë, që publikojnë analiza financiare në fushën e letrave me vlerë, regjistri përmban këto të dhëna:

- a. Emri dhe mbiemri i tregtarit*
- b. Kodi i vendosur, sipas aneksit 1.*
- c. Datëlindja dhe arsimimi.*
- c. Data e regjistrimit.*
- d. Numri i NIPT-it.*
- e. Vendi dhe adresa ku kryhet aktiviteti.*
- f. Nr. i tel, fax, website dhe adresa e e-mail.*
- g. Shënime të tjera.*

2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**